

VENDIM
Nr. 37, datë 5.4.2012

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË RISHIKUAR TË INVESTIMEVE TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA
PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE 2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nenit 10 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.4.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e planit të rishikuar të investimeve të “CEZ shpërndarje” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, si dhe në vijim të vendimmarrjes së saj nr. 143, datë 7.12.2011, për miratimin me kusht të planit të investimeve të “CEZ shpërndarje” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014,

konstatoi se:

Plani i rishikuar i investimeve të shoqërisë “CEZ shpërndarje” sh.a. i paraqitur në ERE, pas vendimmarrjes me kusht, është përmirësuar mjaftueshëm si më poshtë:

- Nga pikëpamja e vlerave të investimeve të shpërndara sipas grupimeve konstatohet se përmirësohen raportet e investimeve sipas studimit për reduktimin e humbjeve.

- Në zërin investime në proces dallohet qartë tendenca e uljes së vlerave të mbartura për vitin pasardhës.

- Në zërin investime në nënstacione është reflektuar sugjerimi i ERE-s.

- Në zërin investime në matje është reflektuar sugjerimi për shtyrjen e investimeve në matësit me parapagesë dhe është planifikuar plotësimi i matjes në nënstacione dhe kabina.

- Zëri i investimeve prioritare është detajuar mjaftueshëm dhe dallohet tendenca për të kryer investime që tentojnë uljen e humbjeve dhe sigurinë e furnizimit.

Aplikimi i “CEZ shpërndarje” sh.a. për planin e rishikuar të investimeve për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e rishikuar të investimeve të “CEZ shpërndarje” sh.a. për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 (Plani i investimeve bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani